




Prishtinë, 18 shkurt 2016

Kodi i ZRRE-së: V_787_2016



Nr. 089/16

Data. 22.02.16

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duke u bazuar në:

- Nenin 8, paragrafi 1, nënparagrafi 1.6, nenit 14 paragrafi 2 nënparagrafi 2.16, nenit 18, nenit 22 dhe nenit 23 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji nr. 03/L-185);
- Dispozitat e nenit 64 të Ligjit mbi Menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë (Ligji nr. 03/048);
- Dispozitat e nenit 4 dhe 6 të Rregullës për taksat, dhe
- Vendimin V-732-2015 të datës 10 prill 2015, për lirim të të licencuarve nga pagesa e taksës vjetore,

në seancën e mbajtur ad hoc me datë 18 shkurt 2016 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **NDRYSHOHET** dispozitivi nën I. i vendimit V_732_2015 i datës 10 prill 2015, ku nën pika 2 teksti: "dhe termike (bashkëprodhim)" **FSHIHET**.
- II. **PLOTËSOHET** dispozitivi nën pikën II. të Vendimit V-732-2015 i datës 10 prill 2015 – "Lirohet nga pagesa e taksës vjetore të licencimit për periudhën nga data 15 tetor 2015 deri me 15 prill 2016" dhe shtohet nën-pika 3 me tekstin: **KEK SH.A. TC Kosova B – për prodhimin e energjisë termike (nga Bashkëprodhimi)**.

A R S Y E T I M

- o ZRRE pas arritjes së qëndrueshmërisë financiare dhe me qëllim të harmonizimit të të hyrave me Buxhetin e Zyrës së Rregullatorit për Energji të përcaktuar për vitin 2015, ka nxjerrë Vendimin V_732_2015 me të cilin ka liruar të licencuarit nga pagesa e taksës vjetore të licencimit për periudha të caktuara kohore.
- o Nga NQ Termokos SH.A. është kërkuar që të paguaj taksën vjetore të licencimit vetëm për sasinë e energjisë termike që ka prodhuar në impiantet e veta, pra në ngrohtore nga kaldajat me mazut.
- o Me implementimin e projektit të kogjenerimit licenca e KEK Gjenerimit (TC Kosova B) është modifikuar (ka pësuar ndryshim) me ç'rast TC Kosova B është gjenerues i energjisë elektrike dhe asaj termike. Për këtë, sipas Rregullës së Licencimit dhe Rregullës për Taksat, të nxjerra




nga ZRRE, KEK SH.A. gjenerimi duhet të paguaj po ashtu edhe taksën vjetore të licencimit për prodhimin e energjisë termike.


- ZRRE ka vlerësuar se situatë e tillë është paraparë edhe gjatë shqyrtimit dhe aprovimit të Marrëveshjes për furnizim me energji termike KEK SH.A.- NQ Termokos SH.A., ku është insituar që si komponentë e çmimit të energjisë termike që NQ Termokos SH.A. duhet t'ia paguaj KEK-ut, të jetë edhe pjesa e taksës vjetore të licencimit për energjinë termike (neni 9.1 dhe shtojca 4 e Marrëveshjes).
 - Me vendimin e Bordit të ZRRE (V_732_2015, dt. 10.04.2015) të licencuarit kanë qenë të liruar nga pagesa e taksës kjo nuk është implementuar. Mirëpo me skadimin e këtij lirimi nga pagesa është paraqitur nevoja e reflektimit të këtyre ndryshimeve në faturimin për të licencuarit si më larët.
 - Vendimi V_732_2015 ka përcaktuar se KEK SH.A. TC Kosova B lirohet nga pagesa e taksës vjetore të licencimit për prodhimin e energjisë elektrike dhe termike, për periudhën 01.03. – 31.10.2015 (Pika 'I' e Vendimit). Pra periudha kur në fakt TC Kosova B nuk ka prodhuar energji termike, përveç 15 ditshin e parë të tetorit 2015. Ndërsa në pikën "II" të Vendimit NQ Termokos SH.A. është liruar nga taksa vjetore e licencimit për periudhën 15.10.2015 – 15.04.2016 për prodhimin e energjisë termike në ato raste kur prodhon nga ngrrothorja e vet.
 - KEK SH.A. ka sqaruar se për të implementuar vendimin në tërësi, janë paraqitur disa probleme të natyrës së kontabilitetit financiarë, më saktësisht të procedurave të brendshme të regjistrimit në kontabilitetin financiar të KEK-ut. Gjithashtu për muajt nëntor dhe dhjetor të vitit 2015, KEK SH.A. nuk ka prezentuar të dhënat për energjinë termike me arsyetimin se janë të përfshira në energjinë elektrike totale (që nuk është vlerësuar si e saktë nga ne) - rrjedhimisht për këtë energji nuk është faturuar taksa e licencimit.
 - ZRRE ka konsideruar se për të ju lënë kohë të dy ndërmarrjeve që të përfundojnë përgatitjet e duhura për implementimin e plotë të marrëveshjes KEK SH.A. dhe NQ Termokos SH.A. është dashur të bëhet ndryshimi i Vendimit të ZRRE V_732_2015, dt. 10 prill 2015.
 - ZRRE ka vlerësua gjithashtu se saktësimi i periudhës duhet të merret për bazë për të përcaktuar pagesat e taksave vjetore të licencimit nga KEK Sh. A. TC Kosova B, e po ashtu edhe për faturimin e furnizimit me energji termike nga KEK Sh.A. për NQ "Termokos"Sh. A.
 - ZRRE, pas vlerësimit të kërkesave dhe dëshmimeve relevante, e duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- III. Me këtë vendim KEK SH.A. lirohet nga pagesa e taksës për prodhimin e energjisë termike vetëm gjer më 15 prill 2016 ashtu siç janë liruar edhe NQ Termokos SH.A. dhe NQ Gjakova SH.A. Pas kësaj periudhe, konkretisht prej fillimit të sezonit të ardhshëm (15 tetor 2016), duhet plotësisht të paguhet taksat siç është e përcaktuar me legjislacionin sekondarë të ZRRE-së.
- IV. Vendim nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- V. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.





Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së


Enver Halimi, kryesues


Krenar Bujupi, anëtar


Arsim Janova, anëtar


Qemajl Mustafa, anëtar


Besim Sejfiqaj, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Të licencuarve: KEK Sh. A. TC Kosova B dhe NQ "Termokos" Sh.A;
- Zyrtarit Kryesor financiar të ZRRE-së; dhe
- Arkivit të ZRRE-së.